



## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

06.Nr.1036  
Data : 23.07.2024

Në bazë të Ligjit NR.03/L-164 për Financimin e programeve të veçanta dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.23/2010 për procedurat e shpalljes së veçantë të banimit si dhe Vendimit të Kuvendit Komunal me nr.01.Nr. 016-34919 datë 27.06.2024, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë këtë:

### THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM PËR BONUS BANIM

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë thirrje publike për Bonus Banim, ku me anë të kësaj forme parashihet subvencionimi prej 50% të shumës së qerasë për familjet nevojtare, andaj të drejtë e aplikimit e kanë familjet të cilat:

1. Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale.
2. Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.
  - Vlera e bonus banimit do të jetë 50% e shumës së qirasë minimale të banesave në tregun e lirë në territorin e Komunës së Suharekës për vitin 2024.
  - Përfitues nga kjo thirrje do të jenë pesëmbëdhjetë (15) familje, të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara në thirrjen publike.

#### Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Letërnjoftimi kopje vetëm për aplikuesin;
- Deklarata e bashkësisë familjare;
- Vërtetim që nuk posedon shtëpi banimi (tatimi në pronë);
- Vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale për gjendjen ekonomike;
- Vërtetim nga mjeku për invaliditet/gjendja shëndetësore për aplikuesin;
- Vërtetimi mbi vendbanim e përhershëm;
- Përparësi do të kenë nënat vetë ushqyese.

#### Vërejtje:

- Aplikacionet mund ti merrni në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale tek Parku i qytetit kati tretë;
- Dorëzimi i aplikacioneve bëhet tek zyra numër 1, e gjendjes civile, ato duhet të jenë të mbyllura në zarf dhe të protokolluara;
- Aplikacionet e arritura pas afatit të paraparë dhe ato të pa kompletuara nuk do të shqyrtohen;
- Thirrja publike për aplikim fillon nga data 23.07.2024 dhe përfundon me datë 21.08.2024;
- Lista e përfituesve do të publikohet brenda afatit ligjor;
- Aplikantët duhet të jenë banor të përhershëm të Komunës së Suharekës.

Drejtori i DSHMS  
Ma.Sc. Besa KUQI

